

**Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina**

**Udhëzuesit të Kontabilitetit Rregullator për  
Furnizimin me Ujë dhe Kërkesat e Raportimit**

**Draft 01**

Tetor 2007

**Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina**  
**Udhëzuesit e Kontabilitetit Rregullator për Furnizim me Ujë dhe**  
**Kërkesat e Raportimit**

**Draft 01**

Tetor 2007

**Përmbajtje**

Parathënie.....	1
1. Përkufizimet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2. Konceptet e përgjithshme.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1 Udhëzuesitë e kontabilitetit rregullator.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.2 Raportimit.....	5
3. Aktivitetet.....	7
3.1 Ndarja e aktiviteteve themelore dhe aktiviteteve jo-themelore .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.2 Ndarja e aktiviteteve themelore sipas strukturave të tarifave.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4. Kostot operative .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1 Pjesa e përgjithshme .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5. Kategoritë e asetëve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.1 Klasifikimi i shpenzimeve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5.2 Kategoritë e shpenzimeve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. Kontabiliteti për mirëmbajtjen kapitale .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.1 Amortizimi i kostos aktuale (asetet që nuk i takojnë infrastrukturës).....	12
6.2 Përtëritje e infrastrukturës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.3 Vlera rregullatore e kapitalit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. Të dhënat teknike të raportimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca 1 – Klasifikimi i shpenzimeve kapitale sipas llojit të asetit dhe qëllimit .....	14

## PARATHËNIE

*[Vërejtje: Ky dokument është draft i parë i përkohshëm që do të përdoret vetëm si bazë për diskutim]*

Ky draft i parë i udhëzuesve të kontabilitetit rregullator për furnizimin me ujë dhe kërkesat e raportimit përcakton kërkesat fillestare të ZRRUM-it për informacion me qëllim të përmbushjes së detyrës së përcaktimit të tarifave, bazuar në draftin e Procedurave të Tarifave të Furnizimit me Ujë.

Një element i rëndësishëm i programit përfshinë krijimin e modelit dhe fazën testuese. Kjo kërkon bashkëpunim dhe përkrahjen e ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë në ofrimin e të dhënave të nevojshme (të audituara ose jo të audituara) me qëllim që testet të kryhen në atë mënyrë që rezultatet e tyre mundësisht të reflektojnë kostot reale dhe performancën e shitjeve.

Këta udhëzuesë përmbajnë komente që janë të paraqitura me *[fontin (shkronjat) italike brenda kllapave të mëdha]*. Këto komente nuk janë përmbajtje e udhëzuesve por ofrojnë komente që janë përdorur në mënyrë të arsyeshme, në aspektet ku vendimet duhet të mirren dhe të bëhen supozimet. Komentet e tilla mund të largohen nga versioni final të udhëzuesve por përfshihen në këtë dokument për të ndihmuar debatimin dhe diskutimin para adoptimit final të grupit të udhëzuesve.

## 1. PËRKUFIZIMET

**Asetet e adoptuara:** Asetet fikse të financuara nga ndërmarrësi apo shfrytëzuesi ku prona bartet tek ndërmarrja, vlera e së cilës nuk i shtohet vlerës rregullatore të kapitalit.

**Ekuivalenca e gjërë:** koncepti ku kostot afatgjate të shpenzimeve të mirëmbajtjes janë të krahasueshme me taksat afatgjate të kostos aktuale të amortizimit në gjendje të qëndrueshme.

**Modeli tarifor i aseteve kapitale :** Asrjetimi ekonomik për përcaktimin e marrëdhënieve të rrezikut të kthimit dhe kthimet e pritura të tipeve specifike të industrisë, p.sh. furnizimi me ujë.

**Kontributet e kapitalit:** Të hyrat e siguruara si kontribute ndaj investimeve nga pala e tretë, p.sh. taksat e infrastrukturës dhe kontributet për aktivitetet siç janë devijimet në lidhjet e gypave.

**Mirëmbajtja e kapitalit:** Aktiviteti i planifikuar i kryer nga ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me qëllim të krijimit të bazës së shërbimit për konsumatorët.

**Kontabiliteti aktual i kostove:** Metoda e kontabilitetit, fillimisht e përcaktuar për çështjen e paraqitjes së efektit të inflacionit në fitimet e bizneseve. Në vend që asetet të paraqiten me koston e tyre historike (d.m.th. me çmimin e tyre origjinal të blerjes), pa amortizim nëse është nevoja, asetet janë më mirë ta paraqitura me koston aktuale të tyre (kosto zëvendësuese) në kohën e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë e ujit sepse karakteri i gjërë i aseteve kapitale dhe fakti që kostot historike nuk reflektojnë vlerën e vërtetë të aseteve. *[Në mungesë të kostove të detajizuara të zëvendësimit, kostot aktuale që i nënshtrohen inflacionit mund të aplikohen si zëvendësim i tyre]*

**Amortizimi aktual i kostos:** Amortizimi i llogaritur në pajtim me metodat aktuale të kontabilitetit të kostos. *[Për asetet ekzistuese propozohet metoda alternative e bazuar në profilin e shlyerjes së borxheve të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë]*

**Kostot që lidhen me numrin e konsumatorëve:** Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve, p.sh. leximi i ujëmatësit, faturimi, etj.

**Nivelet e ngritura të shërbimit:** Përmirësimet e përhershme, të identifikueshme dhe të matshme të niveleve të shërbimit që janë mbi nivelin aktual bazë.

**Përmirësimi:** përmirësimi dhe ngritja e bazës së aseteve përmes niveleve të ngritura të përmirësimit dhe/ose zgjerimit të sistemit.

**Ex-ante:** Metodologjia e llogaritjes e bazuar në projeksionet e kostos dhe të hyrave.

**Kostot fikse:** Kostot operative që nuk lidhen me numrin e konsumatorëve dhe vëllimin e ujit

**Grantet:** Të hyrat(finance) e siguruara për investimet apo ofrimin e shërbimeve për të cilat nuk kërkohet kurfarë repayment. Këtu përfshihet granti që është ekuivalent me shndërrimin e huave të buta në grante dhe huatë komerciale. Investimet e infrastrukturës të financuara nga grantet nuk i shtohen as taksës për përtëritjen e infrastrukturës dhe as vlerës rregullatore të kapitalit.

**Të indeksuar:** Kostot dhe të hyrat të përshtatura për inflacion në pajtim me indikatorët e inflacionit

**Asetet e infrastrukturës:** Kryesisht asetet nëntokësore siç janë tubacionet e ujit si dhe pendat e ujit dhe akumulacionet me kohëzgjatje të madhe. Është bërë një dallim në mes të aseteve të infrastrukturës dhe atyre që nuk i përkasin infrastrukturës për shkak të mënyrës së menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së aseteve nga ofruesitë regjional të shërbimit të ujit.

**Taksat e infrastrukturës:** Të paguara nga ndërmarrësitë dhe konsumatorët në pronat e reja për kyçjen e parë të objekteve për qëllimet e amvisërisë deri te të furnizimit publik të ujit apo kanalizimit publik.

**Taksat për përtëritjen e infrastrukturës:** Provizioni i kontabilitetit vjetor për shpenzimet e përtëritjes së aseteve të infrastrukturës (d.m.th. kryesisht nëntokësore) i ngarkuar fitimit rregullator dhe llogarisë së humbjeve.

**Faktori K:** Faktori i shprehur si përqindje që reflekton rritjet apo uljet reale të tarifave para përshtatjeve të inflacionit.

**Uji i Pa-faturuar (UPF):** Vëllimi i ujit të trajtuar dhe i cili hyn në sistem që nuk prodhon të hyra për ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë.

**Asetet që nuk i përkasin infrastrukturës:** Kryesisht asetet mbitorësore siç janë punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujit, stacionet e pompimit dhe laboratorët e kompanive, depotë dhe workshop-et.

**Borxhet e pakompensueshme:** Një vlerë e lejuar për pagesat e papaguara ndaj ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë për të cilat nuk ekzistojnë gjasa për t'u paguar dhe të cilat do të konsiderohen si të shlyera në pajtim me praktikatat konvencionale të kontabilitetit.

**Kostot operative:** Kostot direkte operative lidhur me ofrimin e shërbimeve që përfshijnë: fuqinë punëtore; energjinë; kemikaljet; materialet shpenzuese; shpenzimet e paplanifikuara; taksat e pakompensueshme dhe shpenzimet e tjera.

**Tarifat reale:** Kostot dhe të hyrat e shprehura në tarifa si në datën e vendosjes, p.sh. mesi i vitit 2008.

**Kalendari rregullator:** Orari i aktiviteteve që duhet të ndërmerren nga ofruesitë regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë, ZRRUM-i dhe të tjerët me qëllim të përmbushjes së obligimeve të tyre në afat të caktuar. Aktivitetet përfshijnë përgatitjen e procedurave, konsultimin, testimin, kërkesat për informacion, paraqitjen e tarifave, aprovimin dhe adoptimin e tyre.

**Vlera rregulatore e kapitalit:** Bazë kapitale e përdorur në kufizimet e vendosjes së tarifave dhe është vlera e ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë e cila fiton kthimin e investimeve. Kjo paraqet vlerën e hapur të investimeve të bëra dhe borxhin, kapitalin e punës, ekuitetin e qeverisë [*pjesë e politikës së qeverisë*] dhe shpenzimet e reja kapitale. Vlera kapitale llogaritet pas amortizimit aktual të kostos.

**Kthimi në kapital:** kthimi në vlerën rregulatore të kapitalit i paraqitur si të hyrat vjetore dhe rritja e kapitalit nga investimet të shprehura si përqindje e investimit origjinal.

**Kërkesat e të hyrave:** Kërkesa e të hyrave vjetore të nevojshme për të financuar aktivitetet e ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë duke përfshirë kthimin në kapital. Këtu përfshihen: kostot operative; taksa për përtëritjen e infrastrukturës; amortizimi aktual i kostos; kthimi në kapital dhe kostot e tjera sipas nevojës.

**Premium i rrezikut:** Kthimi mbi rrezikun pa kthim që reflekton rrezikun e sektorit ose të biznesit.

**Procesi i përshtatjes (Smoothing):** Procesi i përshtatjes së tarifave deri te zëvendësimi i ndryshueshmërisë në tarifava me anë të përshtatjeve uniforme (ose gati uniforme) dhe ekuivalente të përqindjes por ende me të njëjtën vlerën aktuale neto të rrjedhjes së të hyrave.

**Balancim i kërkesës së furnizimit:** Hendeku në mes të furnizimit dhe kërkesës, ose përmes kërkesës nga konsumatorët e ri apo kërkesën e rritur nga konsumatorët ekzistues për të cilën nevojitet investimi shtesë për të siguruar që kërkesa për shërbimet është plotësuar.

**Të paindeksuar:** Kostot dhe të hyrat që nuk janë të përshtatura për inflacion.

**Kostot operative që lidhen me vëllim e ujit:** Kostot operative që lidhen me vëllimin e ujit, p.sh. taksat për ujin e papërpunuar, kemikaljet për trajtim dhe energjia për pompim.

**Mesatarja e peshuar e kostos kapitale (MPKK):** Mesatarja e peshuar e interesit të borxhit dhe pritjet e investitorit të shprehur si përqindje e kthimit të kapitalit total.

**Kapitali i punës:** Kapitali i nevojshëm për të financuar kostot periodike të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë. Në kontekst të këtyre procedurave, kapitali i punës nuk është domosdomërisht përkufizim i saktë i kontabilitetit por më shumë reflekton nevojat aktuale të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë, p.sh. qarkullimi tre mujor.

## **2. KONCEPTET E PËRGJITHSHME**

### **2.1 Udhëzuesitë rregullator të kontabilitetit**

2.1.1 Rregullat konvencionale të kontabilitetit të bazuara në kostot historike dhe metodat konvencionale të amortizimit njihen si metodat e pranueshme të raportimit financiar por kanë mori kufizimesh, veçanërisht lidhur me kthimin në kapitalin e fituar dhe amortizimin real në industrinë e qëndrueshme kapitale me asetet afatgjate siç është industria e ujit. Në praninë e inflacionit, këto kufizime shpiejnë në:

- Vlerat e zvogëluara të aseteve
- Shkallët e zmadhuara të fitimit, dhe rrjedhimisht
- Kthimin e zmadhuar në kapital dhe shkallët e çrregulluara të kostove që qëndrojnë edhe nëse inflacioni bie në zero

Mangësitë tjera në rregullat konvencionale të kontabilitetit sa i përket shërbimeve të kompanive kanë të bëjnë me vlerësimin e aktivitetit dhe kur financohen nga grantet apo 'asetet e dhuruara' shpiejnë në:

- Provizionet e amortizimit dhe kthimet e kapitalit të ngarkuara tarifave në asetet që nuk janë financuar nga kompania dhe si pasojë e kësaj në
- Tarifat më të larta, se sa që do të duhej të ishin, nëse kompania shpërblehet për investimet e saja financiare

2.1.2 Kontabiliteti rregullator përfshinë ri-vlerësimin e strukturave konvencionale të kontabilitetit të përcaktuara për të mbuluar (tejkualuar) mangësitë e lartpërmendura. Kjo nuk është alternativë e sistemit të krijuar të kontabilitetit por më tepër kërkon informacione shtesë dhe hollësitë se sa ato të nxjerra nga raportimi ekzistues financiar me:

- Përcaktimin e vlerave të aseteve dhe në këtë mënyrë edhe amortizimit për të reflektuar vlerën e tyre të vërtetë të aktiviteteve dhe nivelin e investimit real të bërë nga biznesi (përmes metodave të kontabilitetit aktual të kontabilitetit), dhe rrjedhimisht
- Përcaktimin e kthimit në kapitali që reflekton nivelin e investimit të bërë nga kompania dhe pritjet e tregut.

2.1.3 Veç kësaj, kontabiliteti rregullator përqipet të përcaktoj të hyrat e vërteta dhe kostot e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë me anë:

- Të largimit të kostove dhe të hyrave që lidhen me aktivitetet jo-themelore (nëse ka) p.sh. huazimi i pajisjeve ndërtimore për kompanitë private.
- Të kategorizimit të ndarë të investimeve kapitale sipas qëllimit (mirëmbajtja dhe përmirësimi i kapitalit, me ndarje të mëtejshme të 'përmirësimit' në nënkategori të: kualitetit të përmirësuar, nivelit të përmirësuar të shërbimit dhe balancimit të furnizimit / kërkesës).
- Të krijimit të metodës alternative për ngarkimin e kostove të mirëmbajtjes së kapitalit që reflektojnë kostot reale të mirëmbajtjes së aseteve se sa të provizioneve të amortizimit (kontabiliteti për përtëritjen e infrastrukturës).

### **2.2 Raportimi**

2.2.1 Kërkesat e raportimit ndahen në dy kategori:

- Të dhënat historike që përmbajnë shënimet financiare dhe teknike nga e kaluara
- Projeksionet e performancës së ardhshme financiare dhe teknike

2.2.2 Të dhënat historike raportuese financiare duhet të përmbajnë raporte financiare në pajtim me Udhëzuesitë të Kontabilitetit Rregullator siç është paraqitur në këtë dokument.

- 2.2.3 Të dhënat historike raportuese financiare duhet të përmbajnë përpilimin e të dhënave teknike siç është përcaktuar në këta udhëzuesë dhe në pajtim me kriterin, të përcaktuar aktualisht.
- 2.2.4 Të dhënat historike duhet të përdoren si niveli bazë të performancës financiare dhe si bazë, në të ardhmën, për performancën financiare dhe teknike.
- 2.2.5 Të dhënat historike duhet të përdoren me qëllim të matjes së performancës aktuale të kompanive kundrejt pritjeve në procesin e përcaktimit të tarifave, veçanërisht matja e nivelit të performancës së shërbimit kundrejt shpenzimeve në mirëmbajtjen kapitale.
- 2.2.6 Projektionet e kostove dhe performanca teknike duhet të bazohet në planet e dorëzuara të biznesit që i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm nga ZRRUM-i.



### 3. AKTIVITETET

#### 3.1 Ndarja e aktiviteteve themelore dhe aktiviteteve jo-themelore

3.1.1 Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet duke përfshirë investimet kapitale, kostot operative, shpenzimet e rregullta, kostot e kapitalit dhe zërat e shpenzimeve jo-kesh për aktivitetet themelore duhet vetëm të përfshihen në llogaritë rregullatore.

3.1.2 Aktivitetet themelore për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë janë të paraqitura në Tabelën 1.

Tabela 1 – Aktivitetet themelore / Aktivitetet jo-themelore

Aktiviteti	Aktivitetet themelore	Aktivitetet jo-themelore
Marrja e ujit	Marrja e ujit për trajtim dhe shpërndarjen e tij në rrjetin gypor të ujit	Marrja e ujit për qëllimet e tjera siç është ujitja apo shitjet (e parregulluara) me shumicë të shfrytëzuesve tjerë
Trajtimi i ujit	Trajtimi i ujit para shpërndarjes së tij në rrjetin gypor të ujit për përdorimin nga konsumatorët brenda zonës së përcaktuar të shërbimit të ofruesve të shërbimit	Trajtimi i ujit që duhet të eksportohet ofruesit tjetër të shërbimeve <sup>1</sup> .
Akumulimi i ujit	Akumulimi i ujit të trajtuar dhe të patrajtuar para shpërndarjes së fundit në rrjetin gypor të ujit për përdorim nga konsumatorët brenda zonës së caktuar të shërbimit të ofruesve të shërbimit.	Akumulimi i ujit të trajtuar dhe patrajtuar para eksportimit te ofruesi tjetër i shërbimeve.
Transmisioni dhe shpërndarja e ujit	Transmisioni dhe shpërndarja e ujit në rrjet.	Transmisioni dhe shpërndarja e ujit që duhet të eksportohet ofruesve tjerë të shërbimeve dhe për shitjet (e parregulluara) me shumicë.
Kyçjet e shtëpive	Instalimi i ri dhe riparimi i kyçjeve ekzistuese të shtëpive brenda zonës së përcaktuar të shërbimit	Shërbimet e parregulluara komerciale për konsumatorët, p.sh. riparimet në pjesën e poshtme të pikës së furnizimit të shitjeve të ujit (ujëmates).
Shërbimet e konsumatorëve	Leximi i ujëmatësit, faturimi dhe inkasimi; vetëdijësimi dhe kampanjë mediale sa i përket sistemit gypor të ujit, etj.	Aktivitetet e shërbimeve të konsumatorëve për shërbimet e parregulluara.
Aktivitetet e tjera		Aktivitetet e parregulluara komerciale p.sh. huazimi i pajisjeve ndërtimore.
Shpenzimet e rregullta	Proporcioni i aktiviteteve të rregullta që kanë të bëjnë me aktivitetet themelore	Të gjitha aktivitetet e tjera të rregullta

[Vendosni tabelën e ngjajshme për shërbimet e ujërave të zeza]

<sup>1</sup> Është e debatueshme çështja nëse eksportimi i ujit te ofruesi tjetër i shërbimeve është a po nuk është aktivitet kryesor. Në kuptim të rregullimit nga ZRRUM eksporti i tillë i nënshtrohet rregullorës së ZRRUM-it. Megjithatë, eksportimi i ujit mund të konsiderohet si aktivitet jo-themelore (por i rregulluar) dhe kostot e të hyrat duhet të ndahen nga aktivitetet themelore që ofrojnë konsumatorëve shërbime të furnizimit me ujë në çdo zonë të përcaktuar të shërbimit.

- 3.1.3 Aty ku bëhet ndarja e resurseve në mes të aktiviteteve kryesore dhe aktiviteteve tjera , vetëm një shpërndarje e përshtatshme e kostove të aktiviteteve kryesore duhet të bartet në llogaritë rregullatore.
- 3.1.4 Në mënyrë të ngjajshme, vlerat asetëve fikse dhe provizionet e tyre përkatëse të amortizimit, vetëm për aktivitetet kryesore, duhet të përfshihen në llogaritë rregullatore janë objekt i përcaktimit aktual të kostos të vlerave të asetëve dhe provizioneve të amortizimit siç është përcaktuar në këta udhëzuesë (shih Pikën ?).
- 3.1.5 Cilido aktivitet, kosto apo aset që nuk mund të definohet lehtë nga ofruesi i shërbimeve nëse është aktivitet themelor apo aktivitet jo-themelor duhet të referohet tek ZRRUM-i për përkufizim.

## **3.2 Ndarja e aktiviteteve themelore sipas strukturave të tarifave**

- 3.2.1 Strukturat e tarifave përmbajnë tre komponentë kryesor:
- Tarifa volumetrike (shkallë për m<sup>3</sup> të ujit të shitur)
  - Tarifa e kyçjes për të mbuluar kostot e instalimit të kyçjes së re nga rrjeti deri te prona përfshirë qaforen e tubave, tubat me diametër të vogël, valvulat dhe pjesët e tjera, dhe
  - Taksa e infrastrukturës e paguar nga ndërmarrësitë dhe shfrytëzuesit industrial si kontribut ndaj kostove për plotësimin e kërkesës shtesë të ujit e rezultuar nga ndërtimet e tyre.
- 3.2.2 Llogaritë rregullatore duhet të përfshijnë së paku tri qendra të profitit: shitjet e ujit, taksat e kyçjeve dhe të infrastrukturës, ku secila do të përfshijë të hyrat dhe kosto e çdo aktiviteti të qendrave të profitit.
- 3.2.3 Të hyrat nga shitja e asetëve duhet të regjistrohen si të hyrat për qendrën e përshtatshme të profitit. Aty ku asetet e shitura ndahen në mes se më shumë qendra të profitit.....,
- 3.2.4 Shpenzimet e rregullta dhe kostot e tjera të përgjithshme duhet ndahen në mes të tri qendrave të profitit në përputhje me formulën e shpërndarjes me të cilën do të pajtohet ZRRUM-i.
- 3.2.5 Taksa e infrastrukturës duhet të përcaktohet vetëm në bazë të kostove kapitale (shih Pikën ?).

## **4. KOSTOT OPERATIVE**

### **4.1 Pjesa e përgjithshme**

4.1.1 Kostot operative duhet të regjistrohen në llogaritë rregullatore dhe duhet të strukturohen në atë mënyrë që të identifikojnë kostot relevante të tri nënkategorive kryesore të:

1. Kosmos fikse (që nënkupton kostot operative që nuk lidhen (përkojnë) me numrin e konsumatorëve dhe vëllimin e ujit)
2. Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve
3. Kostot operative që lidhen me vëllimin (duke iu referuar vëllimit të ujit)

4.1.2 Kostot operative duhet të përcaktohen asisoi që mos t'i përfshijnë aktivitetet jo-themelore dhe aktivitetet që lidhen me tarifa, p.sh. kostot e kyçjeve të reja që supozohet që do të balancohen me të hyrat e taksës së kyçjes.

4.1.3 Projektionet e kostos operative duhet të bazohen në nën-ndarjet e ngjajshme.

4.1.4 Të gjitha kostot operative do të trajtohen me anë të metodës ex-ante dhe duhet të vlerësohen sipas çmimeve real (të pa-indeksuara)

4.1.5 Kostot operative të financuara nga grantet dhe kontributet duhet të identifikohen në mënyrë të qartë.

*[paraqitni më shumë detaje lidhur me kërkesat e raportimit, p.sh. planet e biznesit]*

## 5. KATEGORITË E ASETEVE

### 5.1 Klasifikimi i shpenzimeve

5.1.1 Asetet e infrastrukturës përgjithësisht përfshijnë:

- sistemet nëntokësore të tubacioneve dhe kanaleve;
- rezervuaret për deponimin e ujit të papërpunuar;
- digat dhe kanalet;
- tubacionet e llumit; and
- informacionet mbi asetet e infrastrukturës p.sh. shënimet e hulumtimit

Të gjitha asetet e tjera, në përgjithësi ato mbitorësore klasifikohen si asetet që nuk i takojnë infrastrukturës.

5.1.2 Asetet që nuk i takojnë infrastrukturës amortizohen në përputhje me konvencionet aktuale të kontabilitetit, sipas kontabilitetit të kostos historik ose aktual siç është nevoja dhe taksës së duhur të amortizimit të bërë për llogaritë e fitimit dhe të humbjes për të paraqitur konsumin ekonomik nga aktivitetet gjatë vitit.

5.1.3 Asetet e infrastrukturës nuk amortizohen. Taksa për përtëritjen e infrastrukturës (TRI) përfshihet në llogarinë e fitimit dhe humbjeve për të paraqitur mirëmbajtjen e vlerës së aseteve nga biznesi gjatë vitit. TPI duhet të reflektojë vlerësimet e kompanive për nevojat e saj afatgjate të mirëmbajtjes së kapitalit për mbajtjen e nivelit të shërbimeve të aseteve të infrastrukturës dhe kapaciteti operativ. TPI përfshihet në gjendjen e bilancit si provizion (për detyrimet dhe taksat) dhe shpenzimet aktuale në asetet e infrastrukturës mbulohen nga këto provizione ashtu siç kanë ndodhur. Çdo ndryshim nga viti në vit në mes të IRC dhe IRE përfshihet në bilancin e gjendjes si aktual kumulativ ose parapagesë si është nevoja.

### 5.2 Kategoritë e shpenzimeve

5.2.1 Shpenzimet e cilido lloj të aseteve kategorizohen sipas qëllimit të:

- **ofrimt të shërbimeve bazë**, që nevojitet për ruajtjen (bazë aktuale) e nivelit aktual të ofrimt të shërbimeve ndaj konsumatorëve; ose
- **përmirësimi** ku ka rritje të përhershme në nivelin aktual të ofrimt të shërbimit deri te niveli i ri 'bazë'.

Përmirësimi mëtej ndahet si në vijim:

- **kualiteti** ku shpenzimet kërkohen të jenë në përputhje me obligimet e reja (d.m.th. pasi është krijuar niveli bazë i shërbimit) ligjore të kualitetit;
- niveli i **përmirësuar** i shërbimit (NPSH) ku shpenzimet ofrojnë ndryshim të identifikueshëm, të matshëm dhe të përhershëm në nivelin e përgjithshëm të shërbimit për konsumatorët ekzistues mbi standardin e mëparshëm;
- balancim i **furnizimit/kërkesës** (BFK) ku shpenzimet ofrojnë shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza për konsumatorët e ri pa ndikim negative nga niveli aktual i shërbimeve që ofrohen konsumatorëve ekzistues; dhe/ose e akomodojnë konsumin e ngritur të ujit nga konsumatorë ekzistues në nivel aktual të shërbimit.

5.2.2 Mirëmbajtja e zakonshme që nuk është e përfshirë në shpenzimet kapitale dhe shpenzimet e tjera të mirëmbajtjes të paraqitura në bazë të përditshme trajtohen si kostot operative dhe drejtohen në llogarinë e fitimit dhe humbjeve.

5.2.3 Shtojce 1 e këtij udhëzuesi klasifikon kategoritë e shpenzimeve kapitale të infrastrukturës / jo-infrastrukturës dhe sipas qëllimit (Bazë, Kual., ESL, and SDB).

5.2.4 Alokimi proporcional i shpenzimeve kapitale kërkohet në mes të kategorive të qëllimit si është nevoja, d.m.th. ofrimi bazë i shërbimit, nivelet e shërbimit të kualitetit të përmirësuar dhe balancim të furnizimit/kërkesës. Tri kategori të fundit të qëllimit paraqesin përmirësimin: rritje të përhershme në nivelin e shërbimit të ofruar konsumatorëve ekzistues dhe/ose

shërbimin e ofruar konsumatorëve të ri në nivel aktual të shërbimit. Planet e përmirësimit mund të shërbejnë për disa qëllime dhe në raste të shumta mund të përfshijë elementin e punëve të kryera më herët të mirëmbajtjes se sa do të ishte ndryshe e nevojshme. Ky element i avancuar i mirëmbajtjes duhet të alokohet në ofrimin bazë të shërbimeve.

- 5.2.5 Aty ku nivelet e përmirësuar të shërbimeve shfaqen nga shpenzimet e nevojitura për kategoritë e tjera të qëllimit atëherë shpenzimet incremental, nëse ka, duhet të alokohen në NPSH, Alokimi në NPSH duhet të paraqesë vetëm shpenzimet e shkaktuara për qëllime të arritjes së përmirësimeve të identifikueshme, matshme dhe të përhershme në nivelet e përgjithshme të shërbimeve.

## **6. KONTABILITETI PËR MIRËMBAJTJEN KAPITALEE**

### **6.1 Amortizimi i kostos aktuale (asetet që nuk i takojnë infrastrukturës)**

- 6.1.1 Në bazë të asaj që asetet ekzistuese përfshihen në vlerën rregullatore të kapitalit si vlerë e një borxhi afatgjatë që mbahet nga operatorët, si zëvendësim i për amortizimin e këtyre asetëve është profili i shlyerjes së borxheve, sipas nevojës. Kjo duhet të regjistrohet në llogarinë si vlerë e kostos aktuale pa korigjime për inflacionin.
- 6.1.2 Amortizimi në asetet që nuk i takojnë infrastrukturës të realizuar pas *[vendosni datën: propozim 1 janar 2008]* duhet të regjistrohen në llogaritë mbi bazën aktuale të kostos në pajtim me formulën e indeksimit, apo, kur ka të dhëna të mjaftueshme, me vlerat e Asetit Ekuivalent Modern (AEM).
- 6.1.3 Për qëllimet e kontabilitetit rregullator, të gjitha asetet e realizuara në vitin financiar mendohet të jenë realizuara në mes të vitit, d.m.th 30 Qershor.
- 6.1.4 Metoda e indeksimit për përcaktimin e amortizimit aktual vjetor të kostos (AAK) është:

$$\text{CCD} = \frac{P \times f}{L}$$

Ku: P = Çmimi origjinal i asetëve

f = faktor i shtimit të inflacionit nga mesi i vitit të realizimit

L = jetëgjatësia e asetëve (vitet)

*[shumë detaje për paraqitjen e përshtatjeve të P&L rregullator dhe gjendja rregullatore e bilancit]*

### **6.2 Përtëritja e infrastrukturës**

*[detajet mbi regjistrin e përtëritjes së infrastrukturës, rregulat lidhur me grantet dhe kontributet etj.]*

### **6.3 Vlera rregullatore e kapitalit**

*[detajet mbi përcaktimin e VRRK dhe gjendja rregullatore e bilancit]*

## **7. TË DHËNAT MBI RAPORTIMIN TEKNIK**

*[të dhënat aktuale dhe parashikuese lidhur me shitjet, prodhimin, inkasimin e të hyrave, performancën financiare etj. Duhet të jenë në pajtim me sistemet ekzistuese të raportimit vetëm nëse nuk kërkohet ndryshe]*

## **SHTOJCA 1 –KLASIFIKIMI I SHPENZIMEVE KAPITALE SIPAS LLOJIT TË ASETIT DHE QËLLIMIT**

Kjo listë paraqet klasifikimin e investimeve kapitale në mes aseteve të infrastrukturës dhe atyre që nuk i përkasin infrastrukturës sipas qëllimit, bazës së shërbimit apo kualitetit të përmirësuar. Kategoritë e përmirësimit të shërbimeve të 'nivelit të përmirësuar të shërbimit' (NPSH) dhe 'balancim i kërkesës së furnizimit' (BKF) mund të përdoren në të gjitha kategoritë.

### **Zonat e shërbimit të ujit**

Pajisjet e burimit të ujit  
Punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujit  
Tubacionet për shpërndarjen e ujit  
Rezervuaret dhe kullat e ujit  
Stacionet e pompimit  
Menaxhmenti dhe shërbimet e përgjithshme të ujit

### **Zonat e shërbimit të ujërave të zeza**

Kanalizim  
**Headworks**  
Punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujërave të zeza  
Trajtimi i llumit  
Largimi i llumit  
Stacionet e pompimit në rrjet  
Stacionet e pompimit në impiant  
Menaxhmenti dhe shërbimet e përgjithshme të ujërave të zeza

---



Ref	Infrastrukturë ose jo-infrastrukturë	Shërbimet e ujit – të gjitha zonat	Qëllimi i shpenzimit
	Infra ose Jo-infra	Element i punëve vetëm për të arritur përmirësimin e identifikueshëm, të matshëm dhe të përhershëm në nivelet e shërbimit mbi nivelin aktual të shërbimit bazë.	ELS
	Infra ose Jo-infra	Elementi i punëve të kërkuar vetëm për të plotësuar kërkesën nga konsumatorët e rid he/ose kërkesën e rritur nga konsumatorët ekzistues.	SDB

Ref	Infrastrukturë Ose jo-infrastrukturë	Objektet e burimit të ujit	Qëllimi i shpenzimit
		Të gjitha digat dhe rezervaret që mbajnë ujin e papërpunuar; të gjitha stacionet e pompimit në sistemet e ujit të papërpunuar përfshirë stacionet e pompimit në rrjet, kaptazhat e lumit, shpimet dhe puset që kërkojnë dezinfektim të thjeshtë para hyrjes në sistem; dhe të gjitha tubacionet apo akvadaktet që shërbejnë për transferin e ujit të papërpunuar ose në mes të burimeve ose nga burimet në impiant të trajtimit.	
		<b>PUNËT PËR RREGULLIMIN E BURIMEVE</b>	
	Jo-infra	Renovimi i puseve, kaptazhave të lumit dhe objekteve përcjellëse.	Bazë
	Infra	MIRËMBAJTJA E AKUMULACIONIT PËRFSHIRË EDHE SIGURIMIN	Bazë
		Riparimi i digave/tuneleve të ujit, ngritja e lartësisë së murit të digës, zgjerimi i tunelit të ujit, punët rehabilituese.	Bazë
		<b>STACIONET E POMPIMIT</b>	
	Jo-infra	Përtëritja e objekteve tjera deri te stacionet e pompimit të elementit madhësi për madhësi dhe/ose racionalizimit.	Bazë
		<b>RENOVIM I AKVADAKTIT</b>	Bazë
	Infra	Elementi madhësi për madhësi/ madhësi ekuivalente e matjes të zëvendësimit pavarësisht nga materiali	Bazë
	Infra	Gërryerja dhe mveshja për të drejtuar problemet e gjendjes/presionit/rrjedhjes/ndërprerjes.	Bazë
	Infra	Mveshja e shkaktuar vetëm nga nevoja që uji i furnizuar të përmbush kushtet e Rregulloreve të BE-së apo Kosovës mbi Kualitetin e Ujit dhe që rezultojnë që tubat të jenë në gjendje të shpërndajnë ujin sipas standardit të ngritur. Shënim: Gërryerja dhe mveshja pauses duhet të jetë për mirëmbajtjen dhe rrjedhimisht për Bazën.	Qual
	Infra	Ruajtja e përgjithshme e rrjetit përfshirë riparimin, pastrimin, shpërthimin e tubave madhësi për madhësi dhe inspektimi i akvadaktit.	Bazë
	Infra	Riparimi/zëvendësimi i urave të tubave, tuneleve, kanaleve, valvulave dhe pusetave.	Bazë
	Infra	Punët që kanë të bëjnë me sigurimin e pajisjeve alternative me qëllim të mbajtjes së ofrimit të shërbimit bazë.	Bazë
	Infra	Element madhësi për madhësi të diversioneve.	Bazë
		<b>PJESA E PËRGJITHSHME</b>	
	Infra	Punët që përputhen me legjislacionin që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurimin.:	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	
	Infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujit	Qëllimi i shpenzimeve
	Jo-infra	Të gjitha punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujit por që përjashtojnë dezinfektimin e puseve dhe gjithashtu dezinfektimin dytësor që përfshihet në sistemin e shpërndarjes.	Bazë
	Jo-infra	Elementi madhësi për madhësi të objekteve shtesë/përmirësuar të trajtimit, përmirësimet e punëve ekzistuese përfshirë kontrollin mbi përdorimin e instrumenteve dhe automatizimin.	Bazë
	Jo-infra	Kontrulli i ri mbi përdorimin e pajisjeve dhe automatizimi për të përmirësuar efikasitetin operative edhe nëse ajo përmirëson kualitetin e trajtimit.	Bazë
	Jo-infra	Elementi i objekteve shtesë/të përmirësuar të trajtimit që shkaktohen vetëm që të jenë në përputhje me obligimet ligjore të kualitetit për kapacitetin e objekteve aktuale dhe që rezultojnë në objektet e trajtimit të afta për furnizim të ujit sipas standardit të rritur të kualitetit.	Kual
	Jo-infra	Punët që përputhen me legjislacionin që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurimin.	Bazë
	Jo-infra	Punët për përmirësimin e efikasitetit p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Tubacionet për shpërndarjen e ujit	Qëllimi i shpenzimeve
		Të gjitha tubacionet që kanë të bëjnë me furnizim të ujit për përdorim industrial dhe të amvisërisë përfshirë urat përcjellëse të tubave, tunelet, gypat e nënkalimit, valvulat, pusetat dhe objektet përcjellëse të sistemit. TUBACIONET Zëvendësim, duplikim, vendosja e tubave të reja, përforcim, gërryerhe dhe shtresimL	Bazë
	Infra	- zëvendësim i elementeve madhësi për madhësi pavarësisht nga materiali për mirëmbajtjen e ofrimit të shërbimit bazë;	Bazë
	Infra	- ndërtimi i elementeve që dalin vetëm nga nevoja që kapaciteti aktual të jetë në përputhje me obligimet ligjore të kualitetit	Qual
	Infra	Përtëritja e urave të tubave, tuneleve, kanaleve, valvulave dhe pusetave.	Bazë
	Jo-infra	PUNËT PËRCJELLËSE PËR KONSUMATORËT Përtëritja/zëvendësimi i matësve të prurjes/presionit.	Bazë
	Infra	Zëvendësimi/përmirësimi i tubave komunikues të shërbimit: PUNËT TJERA	Bazë
	Infra	Hulumtimi i zonave.	Bazë
	Jo-infra	Monitorimi i presionit dhe i prurjes (përfshirë llogarat mobil)	Bazë
	Jo-infra	Dezinfektimi sekondar.	Bazë
	Infra	Punët që përputhen me legjislacionin që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurimin.	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	Bazë
	Infra	Punët për përmirësimin e efikasitetit p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Rezervuarët dhe kullat e ujit	Qëllimi i shpenzimeve
		Të gjithë rezervuarët dhe kullat për ujin e trajtuar brenda sistemit të furnizimit me ujë dhe objektet për trajtimin e ujit dhe impiant për dezinfektim dytësor në vendin ku gjendet rezervuari. Përfshirë rezervuarët për reduktimin e presionit.	
	Non-infra	Përtëritja e objekteve tjera deri te rezervuarët dhe kullat e ujit.	Bazë
	Non-infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Non-infra	Punët për përmirësimin e efikasitetit p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Stacionet e pompimit – uji i trajtuar	Qëllimi i shpenzimeve
		Stacionet e pompimit që shërbejnë për akumulimin e ujit të trajtuar. Shënim: Stacionet e pompimit në sistemet e ujit të papërpunuar përfshihen në Objektet e Burimit të Ujit dhe lidhen me stacionet e pompimit në objektet e trajtimit të ujit.	
	Non-infra	Përtëritja ose vendosja e objekteve të reja deri te stacionet e pompimit madhësi për madhësi dhe/ose racionalizimit.	Bazë
	Non-infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Non-infra	Punët për përmirësimin e efikasitetit p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Menaxhimi dhe pjesa e përgjithshme – shërbimet e ujit	Qëllimi i shpenzimeve
	Infra	Punët në harta dhe azhurnimi i shënimeve lidhur me përmirësimet përcjellëse të efikasitetit.	Bazë
	Jo-infra	Tokat e reja, ndërtesat, laboratorët, depotë dhe punëtoritë.	Bazë
	Jo-infra	Sistemet e reja të telemetrisë/komunikimeve, pajisjet për kontrollim/monitorim të rrjedhjeve, impiantet dhe pajisjet për analizim/mostrim, tokat, laboratorët, depotë dhe punëtoritë.	Bazë
	Jo-infra	Përtëritja ose vendosja e kompjuterëve të ri (përfshirë software-et), automjetet dhe impiant lëvizës.	Bazë
	Jo-infra	Rekreacioni/ruajtja.	Bazë
	Jo-infra	Sigurimi i objekteve.	Bazë
	Jo-infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Jo-infra	Punët për përmirësimin e efikasitetit p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Shërbimet e ujërave të zeza – të gjitha zonat	Qëllimi i shpenzimeve
	Infra or non- infra	Element i punëve vetëm për të arritur përmirësimin e identifikueshëm, të matshëm dhe të përhershëm në nivelet e shërbimit mbi nivelin aktual të shërbimit bazë.	ELS
	Infra or non- infra	Elementi i punëve të kërkuar vetëm për të plotësuar kërkesën nga konsumatorët e rid he/ose kërkesën e rritur nga konsumatorët ekzistues.	SDB

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Largimi i ujërave të zeza	Qëllimi i shpenzimeve
		Të gjitha ujërat e ndotura, të kombinuara, ujërat sipërfaqësore dhe të kanalizimit përfshirë pusetat, kapërderdhjet, tubacionet e kanalizimit nën presion, sifonat dhe kanalet transferuese.  Dyfishimi/përtëritja/zëvendësimi/nevoja për kalim të gypave të kanalizimit, kanalet ndërlidhëse, kapërderdhësat e shiut, kapaciteti deponues dhe kapak dhe shkallët e pusetave, hulumtimi i zonave të drenimit përfshirë inspektimin e rrjedhjes dhe shënimet të pëllgjeve specifike.	
	Infra	- elementi metric madhësi për madhësi/ekuivalent, racionalizimi;	Bazë
	Infra	- elementet që nevojiten vetëm për përmirësimin e kapërderdhësve të pamjaftueshëm ose për të përmbushur rregulloret dhe lejet për shkarkime të reja.	Kual
	Infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Headworks	Qëllimi i shpenzimeve
	Jo-infra	Përtëritja/renovimi/ të elementin madhësi për madhësi të punëve tjera/racionalizim;	Bazë
	Jo-infra	Elementet që nevojiten vetëm për të përmbushur obligimet ligjore të kualitetit që rezultojnë që kapaciteti aktual të jetë në gjendje të trajtojë efluentin sipas standardeve të kërkuara të kualitetit.	Kual
	Jo-infra	Përtëritja/kontrolli i instrumenteve dhe automatizimi edhe nëse përmirëson kualitetin e trajtimit.	Bazë
	Infra	Punët që përputhen me legjislacionin që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurimin.	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	
	Infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujërave të zeza	Qëllimi i shpenzimeve
		Përfshinë të gjitha objektet për trajtimin e ujërave të zeza me një ose më tepër faza të trajtimit, pajisjet përcjellëse të pompimit dhe rezervuaret e llumit me mundësi të tharjes. Objektet e reja të trajtimit që kryhen me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të trajtimit	
	Jo-nfra	- element madhësi për madhësi dhe racionalizimi;	Bazë
	Jo-infra	- elementi që kërkohet vetëm për të përmbushur obligimet ligjore të kualitetit.	Kual
	Non-infra	Kontrolli mbi përdorimin e instrumenteve të reja dhe automatizimi për të përmirësuar eficiencën operative edhe nëse ajo e përmirëson kualitetin e trajtimit, përtëritjet e objekteve ekzistuese të trajtimit dhe kontrolli mbi instrumentet dhe automatizimi për elementin e madhësisë të objekteve tjera të përcjellura te objektet për përmirësimin e kapaciteti të trajtimit.	Bazë
	Jo-infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Jo-infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Trajtimi i llumit	Qëllimi i shpenzimeve
		Të gjitha impiantet e trajtimit të llumit që e ndrojnë natyrën e llumit të papërpunuar para largimit të tij final. Përmirësimi/vendosja e objekteve të reja të trajtimit/ruajtjes, përtëritja e objekteve ekzistuese të trajtimit të llumit, stacionet e pompimit:	
	Jo-infra	- element madhësi për madhësi dhe racionalizimi;	Bazë
	Jo-infra	- Elementi që nevojitet vetëm për të përmbushur obligimet ligjore të kualitetit mbi largimin e sasisë ekzistuese të llumit apo për sasi të e rritura të llumit që rezultojnë nga standardet e kualitetit.	Kual
	Jo-infra	Kontrolli i përdorimit të ri të pajisjeve dhe automatizimi për të përmirësuar eficiencën operative edhe nëse përmirëson kapacitetin.	Bazë
	Jo-infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Jo-infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Largimi i llumit (me përjashtim të automjeteve)	Qëllimi i shpenzimeve
		Përfshinë të gjitha rregullimet transferuese dhe të impianteve që lidhen me largimin final të llumit të trajtuar. Automjetet për largimin e llumit përfshihen në pjesën Menaxhmenti dhe Shërbimet e Përgjithshme.	
	Infra	Mirëmbajtja e gypave të llumit.	Bazë
	Jo-infra	Mirëmbajtja e objekteve kryesore, impiant për largimin e llumit.	Bazë
	Infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	
	Infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë
	Jo-infra	- nëntokësore; - mbitokësore.	

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Stacionet e pompimit	Qëllimi i shpenzimeve
	Jo-infra	Të gjitha stacionet e pompimit me sistem të kanalizimit dhe stacionet përkohshme të pompimit.	Bazë
	Jo-infra	Përtëritja/racionalizim i strukturave, pajisjeve mekanike, elektrike dhe largësimatëse.	Bazë
	Jo-infra	Punët që përputhen me legjislacionin e Shëndetit dhe Sigurimit.	Bazë
	Jo-infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë

Ref	Infrastrukturë Ose jo- infrastrukturë	Menaxhimi dhe pjesa e përgjithshme– shërbimet e ujërave të zeza	Qëllimi i shpenzimeve
	Infra	Punët në harta dhe azhurnimi i shënimeve lidhur me përmirësimet përcjellëse të efijencës.	Bazë
	Jo-infra	Tokat e reja, ndërtesat, laboratorët, depotë dhe punëtoritë.	Bazë
	Jo-infra	Sistemet e reja të telemetrisë/komunikimeve, pajisjet për kontrollim/monitorim të rrjedhjeve, impiantet dhe pajisjet për analizim/mostrim, tokat, laboratorët, depotë dhe punëtoritë.	Bazë
	Jo-infra	Kompjuterët e ri/përtëritje (përfshirë software-in), veturat dhe impiant lëvizës.	Bazë
	Jo-infra	Rekreacioni/ruajta.	Bazë
	Jo-infra	Sigurimi i objekteve.	Bazë
	Jo-infra	Punët që përputhen me legjislacionin që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurimin.	Bazë
	Jo-infra	Punët për përmirësimin e efijencës p.sh. ruajtje e energjisë	Bazë